

You have downloaded a document from



*The Central and Eastern European Online Library*

The joined archive of hundreds of Central-, East- and South-East-European publishers, research institutes, and various content providers

**Source:** Studime Historike

Historical Studies

**Location:** Albania

**Author(s):** Edmond Malaj

**Title:** FAMILJET FISNIKE TË DRISHTIT MESJETAR

Noble families in the Medieval Drinaso

**Issue:** 03-04/2013

**Citation style:** Edmond Malaj. "FAMILJET FISNIKE TË DRISHTIT MESJETAR". Studime Historike 03-04:023-050.

<https://www.ceeol.com/search/article-detail?id=462535>

**EDMOND MALAJ**

## **FAMILJET FISNIKE TË DRISHTIT MESJETAR**

Në këtë artikull nuk pretendoj të jap një pasqyrë të plotë të familjeve më të rëndësishme të qytetit mesjetar verior Drisht, por të paraqes disa nga ato, të cilat kam mundur të gjej deri më sot në kuadër të hulumtimeve të mia në lidhje me historinë e këtij qyteti. Fakti që gjatë këtyre hulumtimeve, në lidhje me historinë e këtij qyteti po has gjithnjë e më tepër në familje të tjera të panjohura më parë për mua, më bën të jem modest dhe ta quaj këtë artikull si një pasqyrë të paplotë, megjithëse numri i familjeve që do të merren në shqyrtim nuk është i vogël.

Familjet fisnike me origjinë nga Drishti që hasen nëpër dokumente janë të shumta megjithatë si për çdo tematikë e lidhur me historinë e Drishtit, edhe aktiviteti i këtyre familjeve në jetën politike dhe ekonomike qoftë brenda qytetit, qoftë jashtë tij nuk mund të hulumtohet në mënyrë shteruese për shkak të burimeve jo të plota dhe të mangëta në lidhje me to. Në artikull kam vendosur që të përdor formën e shqiptarizuar të emrave të këtyre familjeve, pasi këta emra kështu gjenden tashmë edhe në literaturën shkencore historike të sotshme, por krahas versionit shqip, për të shmangur çdo konfuzion do të jap në kllapa edhe emrat në formën origjinale, d.m.th. në atë formë që gjendet nëpër dokumente. Në lidhje me kohën e historisë së këtyre familjeve jam kufizuar vetëm në Mesjetë.

Historia e tyre pas pushtimit osman të Drishtit, e cila për shumë nga këto familje vazhdon më tej në emigrim, në këtë artikull nuk do të merret në shqyrtim, pasi një gjë e tillë do të kapërcente kuadrin e tij. Në artikull do të merren në shqyrtim dy grupe familjesh. Grupi i parë përbëhet nga familjet më kryesore që gjenden dendur nëpër dokumente dhe që kanë luajtur një rol të rëndësishëm në historinë e Drishtit, ndërsa grupi i dytë përbëhet nga familje të një rëndësie më të vogël, fisnikëria e të cilave vihet në diskutim.

## Fisnikëria e lartë e Drishtit

Po e nis me familjen kryesore të Drishtit, me Engjëllorët. Familja *Engjëlli (Angelus)*, ose Engjëllorët e Drishtit, siç përmenden në botime të ndryshme, ishin familja kryesore e qytetit. Në fletën e fundit të “Statuteve” të kapitullit të katedrales së Drishtit jepet edhe një listë, përmbajtjen e së cilës po e japim edhe më poshtë.




Fig. 1. Stema e Engjëllorëve sipas Jaho Brahajit

I pari në këtë pemë gjenologjike është Isak Engjëlli (*Ixacius Angelus*) që qe paraardhës i Aleks Engjëllit (*Alexius Angelus*) i cili mbante titullin e nderit “Imperator”, pas këtij vjen Aleks Andrea Engjëlli (*Alexius Andreas Angelus*) (ndoshta Andrea Aleks Engjëlli), e më pas Mihael Engjëlli (*Michael Angelus*), i cili ishte nëpunës i lartë i shtetit (*comes*) në Durrës, pas tij një Andrea Engjëlli tjetër (*Anderas Angelus*), i cili po ashtu ishte nëpunës i lartë i shtetit (*comes*) në Durrës; më pas përsëri një Mihael Engjëlli (*Michael Angelus*), i cili njihej edhe me

emrin *Elias Petrus*, më pas Andrea Engjëlli i tretë me këtë emër (*Anderas Angelus*), i cili po ashtu ishte funksionar i lartë i komunës (*comes*) dhe përfundimisht edhe vëllezërit Pal Engjëlli i famshëm, kryeipeshkëv i Durrësit (*Paulus Angelus Episcopus Dyrrachiensis*) dhe Pjetër Engjëllin (*Petrus Angelus*)”.<sup>1</sup> Megjithatë kjo gjenealogji nuk është e plotë dhe kësaj familje do t’i kthehemi edhe një herë me një version tjetër që i përket kohës së Rilindjes Evropiane, të cilën e kemi nxjerrë nga vepra e Degrandit.

Tani në lidhje me Pal Engjëllin po japim disa informacione disi më të zgjeruara ngaqë ai është një figurë me rëndësi jo vetëm në historinë e familjes së Engjëllorëve dhe për historinë e Katolicizmit në Shqipëri, por edhe për historinë e kohës së Skënderbeut, sepse ai bashkë me të vëllanë

<sup>1</sup> *Statutet dhe urdhëresat e Kapitullit të Kishës Katedrale të Drishtit (Statuta et Ordinationes Capituli Ecclesiae Cathedralis Drivastensis)*, përgatitur për botim nga Dr. Musa Ahmeti dhe Dr. Etleva Lala, Tiranë: OMBRA GVG, 2009, f. 191.

e tij Pjetër Engjëllin patën qenë jo vetëm bashkëkohës, por edhe bashkëluftëtarë dhe të njohur të Skënderbeut.

Pal Engjëlli kishte me të vërtetë si mbiemër familjar emrin *Angelus* (Engjëlli). Para se të bëhej arqipeshkëv i Durrësit, ai kishte qenë arqidiakon i Durrësit, dhe i dhuron kishës së këtij qyteti një shumë prej 50 florintash.<sup>2</sup> Arqipeshkëv i Durrësit ai u bë më 19 mars të vitit 1460, i shuguruar nga Papa Piu II (*Enea Silvio de Piccolomini*), dhe në atë kohë mbante titullin akademik “*Bakalaureat në Ligjet e Kishës*” (lat. *baccalaureus in decretorum*)<sup>3</sup>. Sipas Shuflajt, mund të supozohet që ai të ketë qenë një durrsak i lindur, që nuk ishte nga Drishti, por vëllai i tij Pjetri kishte shkuar nga Durrësi në Drisht, për t’u bërë kështu një paraardhës i familjes Angelus (Engjëlli), që e mori titullin “Dukët e Drishtit” (*ducibus Drivasti*) në shekullin XVI.<sup>4</sup> Megjithatë nga ana tjetër duken edhe lidhjet e qarta me Drishtin, sepse ai në vitin 1460 i dhuron një shumë prej 60 florintash manastirit të Shën Gjonit të Strilalit (sot Shtoj), i cili i përkiste Ipeshkëvisë së Drishtit.<sup>5</sup>

<sup>2</sup> “*Paulus (Angelus), adiac. Dur., bacc. in decr./ 1460 Mart. 19/ Pii II a. 2 Lat. 1. pr. .1 114. ... Obi. se person. 1460 Apr. 2 pro eccl. Duracen. (50 fl.)*” Hierarchia Catholica Medii Aevi sive Summorum Pontificium, S. R. E. Cardinalium, Ecclesiarum Antistitum series. Ab anno 1431 usque ad annum 1503 perducta. E documentis Tabularii praesertim Vaticani collecta, digesta, edita per Conradum Eubel, S. Theol. Doct. Ord. Min. Conv. Definitorem Generalem olim Apostolicam apud S. Petrum de Urbe Poenitentiarum. Editi altera. Sumptibus et Typis Librariae Regensbergianae. Monasterii MDCCCXIV, f. 148.

<sup>3</sup> “*Paulus (Angelus), adiac. Dur., bacc. in decr.*”. *Po aty*, f. 148.

<sup>4</sup> Milan von Šufflay, “Kirchenzustände im vortürkischen Albanien. Die orthodoxe Durchbruchzone im katholischen Damme”, në: *Illyrisch-Albanische Forschungen*. Unter Mitwirkung von Professor Dr. Konstantin Jireček, Professor Dr. Milan von Šufflay, Sektionsschef Theodor Ippen, Professor E. C. Sedlmayr, Archivar Dr. Josef Ivanič, Weiland Emmerich von Karácson, K. Ung. Sektionsrat Béla Péch und Karl Thopia. Zusammengestellt von Dr. Ludwig von Thallóczy. I. Band. Mit einer Landkarte. München/Leipzig: Duncker und Humblot 1916, f. 225. Shih edhe: Shih edhe: *Acta et Diplomata res Albaniae Mediae Aetatis illustrantia*. Collegerunt et digesserunt Dr. Ludovigus de Thallóczy, Dr. Constantinus Jireček ed Dr. Emilianus de Sufflay. Volumen I (Annos 344-1343 tabelamque geographicam continens) Vindobonae MXMXVIII. Typis Adophi Holzhausen., nr. 468. (Më tej cituar si: *AAlb*. I, nr.)

<sup>5</sup> “*Et 15 diebus post pro mon. s. Joannis de Stivalio [Strilalio – E.M.] O. S. B. dioce. Drivasten. sibi in comm. concessio (60 fl.)*”. Hierarchia Catholica Medii Aevi sive Summorum Pontificium, S. R. E. Cardinalium, Ecclesiarum Antistitum series.

Pali duket se ka shkruar një histori të Skënderbeut në vitin 1480 në gjuhën latine me autor anonim. Këtë vepër çuditërisht e zbulon jo të plotë dhe e përdor vetëm prifti italian Xhammaria Biemmi (Giammaria Biemmi), i cili në fillim të shek. XVIII kishte filluar të shkruante një histori të Skënderbeut. Sipas Biemmit, kjo vepër kishte pak a shumë titullin “*Historia e Skënderbeut* botuar nga një shqiptar në Venedik, shtypur nën kujdesin dhe me shpenzimet e Erhard Radolt në Augsburg, në vitin e Zotit 1480, më 2 prill nën qeverisjen e princit shumë të nderuar Johannes Mocenygo”.<sup>6</sup>

Ky autor anonim dhe ekzistenca e veprës së tij prej shumë historianëve janë cilësuar si jo trillime. Franc Babinger dhe Aleks Buda<sup>7</sup>, janë të mendimit se anonimi “Tivarini” dhe vepra e tij e paparë deri më sot janë mistifikime të Biemmit, ngaqë kjo vepër, përveç Biemmit nuk është gjetur as në latinisht, as në ndonjë gjuhë tjetër.<sup>8</sup> Noli shpreh mendimin se një historian serioz siç ishte Biemmi, nuk do të ishte në gjendje të bënte një mashtrim të tillë, dhe se kjo vepër e panjohur në fund të fundit mund të qëndrojë si burim më vete, falë citimeve të shumta që përdor Biemmi nga ajo, të cilat mund të vërtetohen nga burime të tjera.<sup>9</sup>

Disa historianë shqiptar janë të mendimit se shkrimtari anonim, të cilin Biemmi e pagëzon me emrin “Tivarini”, duhet të jetë Pal Engjëlli (Paulus Angelus 1417-1469).<sup>10</sup> Këtë mendim e përforcon Biemmi kur

Ab anno 1198 usque ad annum 1431 perducta. E documentis Tabularii praesertim Vaticani collecta, digesta, edita per Conradum Eubel, S. Theol. Doct. Ord. Min. Conv. Definitorem Generalem olim Apostolicam apud S. Petrum de Urbe Poenitentiarum. Editi altera. Sumptibus et Typis Librariae Regensbergianae. Monasterii MDCCCCXIII (më tej: Eubel, *Hierarchia Catholica* I) f. 148, ref. 3.

<sup>6</sup> “*Explicit Historia Scanderbegi, edita per quendam Albanensem. Venetiis, impressa industria, atque impensa Erhardi Radolt de Augusta anno Domini 1480, die 2. mensis Aprilis ducante Joanne Mocenyco inclyto Duce*”. Giammaria Biemmi, *Istoria di Giorgio Castrioto detto Scander-Begh*, Seconda Edizione, Brescia: Giammaria Rizzardi, 1756, f. 3.

<sup>7</sup> “*Kemi të bëjmë me një falsifikim të një falsifikatori profesionist të shek. XVIII.*” Aleks Buda, “Fan S. Noli, Historian i Skënderbeut”, në: Fan S. Noli, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu 1405-1468*, Tiranë: Naim Frashëri, 1967, f. 8.

<sup>8</sup> Po aty, f. 179.

<sup>9</sup> Po aty, f. 180.

<sup>10</sup> Mikel Prenushi, *Kontribut Shqiptar në rilindjen evropiane*, red. Jani Toçka. Tiranë: 8 Nëntori, 1991, f. 26; Krh. edhe: Kolë Ashta, *Leksiku Historik i Gjuhës Shqipe I*, Shkodër: Universiteti i Shkodrës, 2000, f. 41-42.

shkruan se, ai vinte nga Familja Engjëlli, e cila dikur sundonte në Tivar.<sup>11</sup> Në lidhje me ekzistencën e një “historie të Skënderbeut” të shkruar nga Pal Engjëlli, sipas Kolë Ashtës, na njofton edhe historiani nga Ragusa Pietro Lukari (Pietro Luccari) në veprën e tij “Kopje e përmbledhur e analeve të Raguzës” (*Copioso ristretto degli Annali di Ragusa. Venedik 1605*), ku ai shkruan se e ka pasur në duar dhe e ka përdorur pikërisht këtë vepër.<sup>12</sup> Megjithatë duhet të them këtu që në lidhje me të dhënat e pakta që jep Lukari për jetën dhe aktivitetin e Skënderbeut, nuk përmend asnjë burim.<sup>13</sup> Pal Engjëlli u lind në vitin 1427, dhe më 1460 ai u bë arqipeshkëv i Durrësit.<sup>14</sup>

Sipas Marin Barletit dhe Dhimitër Frangut, kushërirrit të tij, Pal Engjëlli ishte një këshilltar i ngushtë i Skënderbeut, dhe u mundua të ndërmjetësonte midis tij, venedikasve dhe krerëve të tjerë arbër, sidomos Dukagjinëve, të cilët ai u mundua t’i lidhte me forcat e krishtera perëndimore.<sup>15</sup> Ai ishte një dijetar dhe njëri nga humanistët më të rëndësishëm shqiptar, por “*më vonë roli i tij u mbivlerësua dhe të afërmit e tij u përpoqën të përhapnin lajmin, sipas të cilit papa Piu II kishte ndërmend ta emëronte kardinal dhe dokumentet që rreken të mbështesin këtë njoftim janë të rreme dhe i përkasin një periudhe të më vonë*”<sup>16</sup>. Engjëlli ishte ambasador i Skënderbeut dhe e shoqëroi atë për në Raguzë dhe për në Itali. Ai ishte pra një njeri i besueshëm e Skënderbeut dhe një person, të cilin luftëtarët e Skënderbeut e çmonin shumë. Këtë na e vërteton edhe Marin Barleti, kur thotë që ai ishte “*burrë që Skënderbeu e mbante mbi krye për maturinë, kulturën dhe pastërtinë e jetës, që e*

<sup>11</sup> “*Dischendea dalla casa Angeli, che una volta godea la signoria d’Antivari.*” G. Biemmi, *Istoria...*, f. 126.

<sup>12</sup> K. Ashta, *Leksiku Historik ...*, f. 14.

<sup>13</sup> Giacomo Lvccari, *Copioso ristretto de gli Annali di Rausa*. Libri Qvatro. Di Giacomo di Pietro Lvccari, Gentlihomio Rauseo / In Venetia, Ad instantia di Antonio Leonardi 1605, f. 94; “Rrethimi i Krujës dhe Skënderbeu në Raguzë”, f. 96; “Skënderbeu në Raguzë dhe në Napoli”, f. 106; “Vdekja e Skënderbeut”, f. 110.

<sup>14</sup> Paolo Petta, *Despotë të Epirit e princër të Maqedonisë. Mërgata shqiptare në Italinë e periudhës së Rilindjes*, përktheu nga italishtja Pëllumb Xhufi (Titulli në origjinal: Paolo Petta, *Despota d’ Epiro e principi di Macedonia*), Tiranë: IDK, 2000, f. 234.

<sup>15</sup> *Po aty.*

<sup>16</sup> *Po aty.*

*respektonin dhe e ndigjonin si ndonjë orakull gjithë epirotët dhe arbërit*".<sup>17</sup>

Megjithatë Paolo Petta, duke u mbështetur në dokumentet arkivore, është i mendimit që Pal Engjëlli në kohën e pontifikatit të Piut II, nuk mbulonte ende ndonjë detyrë të rëndësishme dhe në atë kohë rolin e ndërmjetësit midis shtetit të Venedikut dhe Skënderbeut e luante një tjetër, që ishte prelati Gjergj Pelini, abat i *Kuvendit të Shën Mërisë së Rotecit* në afërsi të Tivarit.<sup>18</sup> Porse sipas Valentinit gjatë organizimit të kryqëzatës 1455-1458, Pal Engjëlli më 17. IV. 1456 miratohet *nunc* dhe mbledhës ndihmash në Shqipëri, Dalmaci dhe Serbi për këtë kryqëzatë, dhe më 17. IX. 1457 të ardhurat e mbledhura nga ai dhe nga ndihmës të tjerë i dorëzohen Skënderbeut.<sup>19</sup> Dhe kjo nuk ishte një detyrë e parëndësishme.

Rolin si ambasador i Skënderbeut me Venedikun Pal Engjëlli filloi ta luante në vitin 1465. Pasi u bë arqipeshkëv i Durrësit në vitin 1460 dhe pas vdekjes së Skënderbeut në vitin 1468, Venediku e ktheu atë me shpejtësi në Shqipëri, duke i dhënë atij edhe 220 dukatë, me gjykimin se ai duke qenë një person mjaft i matur dhe mjaft i devotshëm, besnik ndaj shtetit të Venedikut dhe duke pasur autoritet te shqiptarët, tek familjarët e Skënderbeut dhe tek tjerët, do të luante një rol të rëndësishëm në ato momente kur zotërimet e Kastriotëve ishin në lëvizje dhe në prag të një shpërthimi të madh dhe do të mund të drejtonte dhe të rregullonte gjërat më me lehtësi.<sup>20</sup>

<sup>17</sup> Marin Barleti, *Historia e Skënderbeut*, përkthimi nga origjinali latinisht dhe hyrja nga Stefan J. Prifti (Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë), Tiranë: Mihal Duri, 1967, f. 430.

<sup>18</sup> P. Petta, *Despotë të Epirit ...*, f. 235.

<sup>19</sup> M. Sciambra, G. Valentini, I. Parrino, *Papa Kaliksti III, Skënderbeu, Shqipëria dhe Kryqëzata (1455-1458)*. Tiranë: Plejad, 2009, f. 238, 240. (= Plejada e Mendimit Albanologjik, Seria "Valentini"), f. 259-260.

<sup>20</sup> "mccccxvii. die 13 februarii. Sicut per litteras vicereactoris nostri Dyrachii iutelligitur, mortuus est magnificus quondam Scandarbegus, ob cuius obitum universa illa provincia in magno tumultu et trepidatione est constituta; unde necessarium est providendum conservationi tam locorum prefati quondam domini Scandarbegi quam nostrorum; propterea vadit pars, quod cum omni possibili celeritate expediatur hinc, et in provincial illam redeat reverendus dominus archiepiscopus Dyrachii, qui apud nos diu stetit orator nomine prefati quondam domini Scandarbegi, et est persona multum prudens et nobis statuique nostro fidelis et devota; habet preterea, et apud uxorem et filium ceterosque tam

Ai ishte gjithashtu edhe njëri nga organizuesit e “Kuvendit të Arbrit” më 8 nëntor 1462 në Mat (Emathia), kuvend ky, që ishte mbledhur të shqyrtonte problemet e mëdha, në të cilat gjendej tashmë vendi, populli dhe kisha e shqiptarëve. Përfundimet e këtij kuvendi Pal Engjëlli i shkroi nën titullin “*Kushtetuta, urdhra dhe statute*”<sup>21</sup> dhe pikërisht në këtë përmbledhje gjendet edhe dokumenti i parë në gjuhën shqipe që është “*Formula e Pagëzimit*” me përmbajtje: “*Un te pagëzont premni Atit et Birit et Spiritit Senit*”. (*Unë të pagëzoj për emnit t’Atit e të Birit e të Shpirtit Shenjtë*) që ishte hartuar për t’u përdorur nga prindërit nëse të porsalindurit ishin në rrezik vdekjeje dhe nuk kishte kohë si dhe nuk ndodhej afër ndonjë klerik për të kryer sakramentin e pagëzimit.

Në këtë shkrim Pal Engjëlli na paraqet edhe statutin politik të Skënderbeut, duke e quajtur atë “Zotin Skanderbeg të Famshëm” dhe

---

*familiares quam subditos prefati quondam domini Scandarbegi creditum et auctoritatem, cuius presentia et consilio sperandum est, res illas facilius dirigi et stabiliri posse. Et quoniam reverenda paternitas sua habere debet, ut asserit, a nostro dominio ducatus circa 220, captum sit, quod denarii predicti eidem domino archiepiscopo dari debeant, et bonis verbis hortetur, ut alacriter vadat et operetur, sicut est consuetus, quoniam dominium nostrum erga eum utetur gratuitate, et ita ut laborum et fidelium operationum suarum merito poterit contentari.”* Šime Ljubić, *Listine o odnašajih između južnogo Slavenstva i Mletačke republike*. Skupio i uredio Šime Ljubić, Pravi Clan Jugoslavenske Akademije znanosti i umjetnosti ITD knjiga X. Od godine 1453 do 1469. Zagreb: U knjizarnica Jugoslavenske Akademije, 1891, nr. CCCCXXIII.

<sup>21</sup> “*Constitutiones, Ordinationes et Statuta ... Paulus Angelus, Miseratione Divina Archiepiscopus Dirrachiensis et Illiricae Regionis. In Ecclesia Sancte Trinitatis de Emathia Anno M.CCCC.LXII. Inciptione Decima, Die vero lune octava mensis Novembris.*” K. Ashta, *Leksiku Historik ...*, f. 27. Sipas Paolo Pettës në këtë përmbledhje dorëshkrimesh përveç çështjeve të mirëfillta kishtare dhe përveç dokumenteve autentike që flasin për dorëzimin e Drishtit në duart e Venedikut dhe dhënien e Durrësit nga ana e Karl Topisë, kishte edhe privilegje dhe certifikata të rreme që ishin sajuar për ti dhënë kredi fisnikërisë së familjes Engjëlli, pastaj një dekret i rremë gjoja i papës Piu II e quan arqipeshkëvin Palë “kardinal” dhe Skënderbeun “mbret të Shqipërisë” dhe kushëri të Palit, ndërsa një dokument tjetër po ashtu i rremë që gjoja ishte marrë nga arkivat e Drishtit, vërteton prejardhjen romake e perandorake të Engjëllorëve. Petta është i mendimit që *Constitutiones* të jetë transkriptim i një dokumenti autentik, të ruajtur nga familja, transkriptim që duhet të jetë bërë para gjysmës së shek. XVI, kohë kur falsifikimet në fjalë kishin marrë një karakter të programuar dhe të organizuar. P. Petta, *Despotë të Epirit...*, f. 247, ref. 35.



“mbretin e pamposhtur të Shqipërisë” (*Sub illustri domino Schenderbegh, Albanie Domino [...] invictissimi regis Albaniae.*)<sup>22</sup> Në këtë fragment të marrë nga Marin Barleti, është e rëndësishme të përmendim që vëllai i madh i Pal Engjëllit, pra Pjetër Engjëlli<sup>23</sup> († 1512) ishte në shërbim të Skënderbeut si kapiten.<sup>24</sup> Pikërisht nga ky vëlla duhet të ketë marrë edhe Pal Engjëlli informacione të sakta në lidhje me Skënderbeun dhe me luftërat e tij.<sup>25</sup> E zgjatëm pak me veprimtarinë e Pal Engjëllit, pasi ai deri tani rezulton si më i shquari i kësaj familje, dhe përveç kësaj ka zënë një vend nderi ndër figurat mesjetare të historisë së Shqipërisë.

Përsa i përket tani kronologjive mbi Engjëllorët, njëriën e sollëm më sipër, por studiuesi Aleksandër Degrand na jep për Engjëllorët një gjenealogji tjetër më të plotë me titull “*Pema gjenealogjike e princërve Engjëlli. Flav Comneni, pasardhës të perandorëve të Lindjes, Mjeshtra të mëdhenj Urdhrit Kalorësiak Perandorak Konstandinian, nën titullin e Shën Gjergjit*”<sup>26</sup> të dhënat e së cilës po i paraqesim si më poshtë,<sup>27</sup> megjithëse për saktësinë e saj ka shumë dyshime. Në këtë gjenealogji është marrë parasysh linja mashkullore, ndërsa emrat e bijave jepen shumë rrallë.

- I. Isaac Engjëlli Flavi Komneni, Perandor i Konstandinopojës, Mjeshtër i Madh XXVI i Urdhrit Perandorak të Kalorësve Kostandinianë të Shën Gjergjit.
- II. Aleks VI Engjëlli Flavi Komneni, Perandor i Konstandinopojës, Mjeshtër i Madh XXXVII
- III. Aleks Engjëll Flavi Komneni, Princ i Maqedonisë, Dukë e Kont i Drishtit, Durrësit, etj. Mjeshtër i Madh XXVIII.

<sup>22</sup> K. Ashta, *Leksiku Historik ...*, f. 30.

<sup>23</sup> *Dokumente të shek. XVI-XVII ...*, Vëll. I, nr. 164.

<sup>24</sup> S. Prifti, “Hyrye”, në: Barleti, *Historia e Skënderbeut*, f. 10.

<sup>25</sup> Po aty.

<sup>26</sup> “*Albero geneologico dei Principi angeli. Flav Comneni, discendenti da gli Imperatori di Oriente, Gran Maestri dell’ Ordine Equestre Imperiale Costandiniano, sotto il titolo de S. Giorgio*” A. Degrand, *Souvenirs de la Haute-Albanie*, par A. Degrand, consul de France, Paris: H. Welter, 1901, pa numër faqeje.

<sup>27</sup> Të gjitha të dhënat për gjenealogjinë e Engjëllorëve të paraqitur këtu janë marrë nga vepra e sipërcituar e Degrandit.

- IV. D. (zoti) Mikel Engjëlli, Flavi, etj., Princ i Maqedonisë, Dukë e Kont i Drishtit, Durrësit, etj. Mjeshtër i Madh XXIX, këshilltar i Perandorisë.
- V. D. (zoti) Andrea, Engjëlli Flavi, etj., Princ i Maqedonisë, Dukë e Kont i Drishtit, Durrësit, etj. Mjeshtër i Madh XXX, etj.
- VI. D. (zoti) Mikel VII. Engjëll Flavi, etj., Princ i Maqedonisë, Dukë e Kont i Drishtit, etj. Mjeshtër i Madh XXXI., etj.
- VII. të bijtë e Mikelit të mësipërm ishin zoti Pal, Dukë e Kont i Drishtit, etj. i lindur në vitin 1390 dhe vdekur në vitin 1453 kur u pushtua Konstandinopoja Mjeshtër i Madh XXXII dhe zoti Andrea II. Engjëlli, Flavi, etj. Dukë e Kont i Drishtit, etj. Mjeshtër i Madh XXXIII. Andrea II Engjëlli kishte dy pasardhës. Ata ishin:
- VIII. Pal Engjëlli Flavi., arqipeshkëv i Durrësit, kardinal i Kishës së shenjtë, i zgjedhur nga papa Piu II. Lindi më 1417 dhe vdiq më 1470,
- IX. Pjetër Engjëlli, Flavi, etj., Dukë e Kont i Drishtit, etj. Mjeshtër i Madh XXXIV, i vëllai i arqipeshkvit të lartpërmendur Pal Engjëlli. I martuar me Luçinë, të bijën e Aleks Shpanit. Pjetër Engjëlli kishte pesë fëmijë që ishin: Aleks, Pali, Xho Demetri, Andrea, Xhirolami, të cilët po i rendisim më poshtë:
- X. Aleks Engjëlli, i përmendur në vitin 1497. Vdiq në luftë kundër turqve;
- XI. Pal Engjëlli, Flavi, etj. Princ i Kaonisë, etj, (1493-1576);
- XII. Xho Demetrio, princ i Cilicisë, Durrësit, Paletto Minore, Dukë e Kont i Drishtit, Mjeshtër i Madh XXXV. I martuar me Françeskinën, fisnike e lartë e Venedikut;
- XIII. Andrea Engjëlli, Flavi, etj. princ i Maqedonisë, Dukë e Kont i Drishtit, Durrës etj. Mjeshtër i Madh XXXVI;
- XIV. Xhirolam Engjëlli, Flavi, etj. princ i Thesalisë, Dukë e Kont i Drishtit, etj. Kont e Kapedan, familjar i vazhdueshëm, kommenzal e Selisë së Shenjtë. Mjeshtër i Madh. XXXVII. I martuar me Orsola Bini. Nga këta djem të Pjetrit, djem kishin vetëm Xho Demetri dhe Xhirolami, të cilët gjithashtu janë të shënuar në pemë. Djali i Xho Demetrios është:
- XV. Pjetër Engjëlli. Flavi, etj. Princ i Cilicisë, i Durrësit dhe i Paletto Minore, Dukë e Kont i Drishtit, Mjeshtër i Madh XXXVIII. (1526-1592) I martuar me Lugrezia Gonti Bevolchi fisnike milaneze. Vëllai tjetër Xhirolami kishte katër djem, Mikelin,

Leonin, Pjetrin dhe Xho Andrian, të cilët po i rendisim më poshtë:

- XVI. Mikel Engjëlli, etj. Princ i Thesalisë, Dukë e Kont i Drishtit, (1557-15623). I martuar me Lucetta Michiele fisnike e Venedikut.
- XVII. – Leon Engjëlli Flavio, etj., Kont i Drishtit.
- XVIII. – Pjetër Engjëlli Flavio, etj., Kont i Drishtit.
- XIX. – Xho (Xhovani) Andrea Engjëlli, Flavio, etj., Kont i Drishtit . I martuar me Camilla Zuccha fisnike e Padovës. Pjetër Engjëlli, i ërmendur më sipër (XV), kishte një pasardhës, Xho (Xhovani) Andrian:
- XX. – Xho (Xhovani) Andrea, Engjëlli Flavio, etj., Princ i Maqedonisë, Dukë e Kont i Drishtit, Mjeshtër i Madh XXXIX (1569-1634). Mikel Engjëlli i lartpërmendur (XVI), kishte dy djem, Engjëll Marinë, Markun, dhe një bijë, Marinë, dhe që të tre po i radhisim më poshtë:
- XXI. Engjëll Maria, etj., Princ i Maqedonisë, Dukë e Kont i Drishtit, i Durrësit, etj. (1600-1678), Mjeshtër i Madh XL;
- XXII. XXII. Mark Engjëlli Flavio, etj., Princ i Maqedonisë, Dukë e Kont i Drishtit, Durrësit, etj., Mjeshtër i Madh XLI; – Maria alla Donna (1603-1670), motër e Engjëllmarisë dhe e Markut, e bija e Mikel Engjëllit (XVI), e cila ishte e martuar me Gjergj Vukoviqin, i quajtur edhe Lazar (†1682). Xho (Xhovani) Andrea (XIX) i përmendur më sipër kishte dy djem, Xhirolamon, dhe Xho (Xhovani) Andrian:
- XXIII. Xhirolamo Engjëlli Flavio., etj., Princ i Maqedonisë, Kont i Drishtit e i Durrësit, Mjeshtër i Madh XLII. I martuar me Chiara Jiorini, fisnike nga Bresha;
- XXIV. Xho (Xhovani) Engjëlli Flavio., etj., Princ i Maqedonisë, Kont i Drishtit, etj. I martuar me Isabella Belli, fisnike nga Viçentina.

Të fundit në këtë gjenealogji janë pasardhësit e Maria Alla Donnas, të bijës së Mikel Engjëllit (XVI) të cilët janë Lucidita e cila vdiq fëmijë, Xho Antoni (1639), i cili u martua me Marina Marinin dhe i treti është i pidentifikuar. Xho Antonia pati dy fëmijë, Miechielle Givannin, që ishte palistjer (1694) dhe Maria alla Donnan (1697). Në lidhje me këtë familje ekzistojnë edhe të dhëna të tjera gjenealogjike, të cilat në disa pika bashkohen me gjenealogjinë e mësipërme, por në shumë të tjera janë të ndryshme. Këto ndodhen tek vepra e autorit Du Cange, me titull

“*Historia Byzantina duplici Commentario illustrata*”.<sup>28</sup> Nga kjo vepër po japim vetëm emrat e anëtarëve të kësaj familjeje, kurse të dhëna të mëtejme, do t’i japim në një punim të mëvonshëm.

Brezi I: Mikel Engjëlli (Michael Angelus), fisnik nga Drishti, i vdekur në vitin 1465. I biri quhej

Brezi II: Andrea Engjëlli (Andrea Angelus), vojvodë i Drishtit, i cili e mbron qytetin kundër një

sulmi të Skënderbeut. Bijtë e tij ishin:

Brezi III: Pjetër Engjëlli (Petrus Angelus), më vonë bashkëluftëtar i Skënderbeut dhe Pal Engjëlli (Paulus Angelus) arqipeshkvi i Durrësit.<sup>29</sup>

Në vepër përmendet dhe Dhimitër Engjëlli (Demetrius Angelus) që u bë rektor i kishës së Shën Gjon Pahëzorit në Briana (Itali), për të cilin mendojmë se bëhet fjalë për Dhimitër Frangun, pastaj më tej, një Aleks Engjëlli (Alexius Angelus), i vdekur në luftë, një Pal Engjëll tjetër që cilësohet si, Princ i Kaonisë, që ishte arqidiakon dhe kanonik i Drishtit, dhe më vonë protonotar apostolik,<sup>30</sup> Andrea Engjëlli (Andrea Angelus), kanonik i Drishtit, që më vonë bëhet rektor i kishës së Shën Engjëllit të Salës në Fushën Padovese,<sup>31</sup> etj., etj, që nuk po i përmendim, këtu të gjithë pasi do t’i kapërcenim së tepërmi kufijtë e këtij artikulli.<sup>32</sup>




Fig. 2: Stema e Shpanëve sipas Jaho Brahajt

<sup>28</sup> *Historia Byzantina duplici Commentario illustrata*. Prior Familias ac Stemmata imperatorum Constantinopolitarum, cum corundem Augustorum Nomismatibus, & aliquod Iconibus; Præterea Familias Dalmaticas & Turcicas complectitur: Alter Descriptionem Urbis Constantinopolitanæ qualis extitit sub Imperatoribus Christianis. Auctore Carolo Du Fresne Domino Du Cange, Regi a Consiliis, Francæ pud ambianos Questore. Venetiis, Ex Typographiæ Bartolomæi Javarina M. DCC. XXIX, f. 173.

<sup>29</sup> Të dhënat për Mikel, Andre, Pjetër dhe Pal Engjëllin nga: C. Du Cange, *Historia Byzantina duplici Commentario illustrata...*, f. 173.

<sup>30</sup> “*Paulus Angelus, Chaoniae Princeps, Archidiaconus & Canonicus Drivastensis, Protonotarius Apostolicus*”. *Po aty*.

<sup>31</sup> *Po aty*.

<sup>32</sup> Të dhëna të plota mbi ta do të ketë në punimin tim *Drivasto*, që është akoma në proces pune.

Pasi i hodhëm kësaj familje fisnike një vështrim të përgjithshëm mund të themi se, pavarësisht se Engjëllorët ishin një familje e madhe dhe e fuqishme, ata nuk kanë pasur kurrë një principatë të tyre.<sup>33</sup> Kaq mund të themi hëpërhë në lidhje me këtë familje.

Familja tjetër, më e ngritur fisnike ishte edhe ajo e quajtur me mbiemrin *Span ose Spano*, serb. *Spanovići*, lat. edhe *Ispanus, Yspanus*, fjalë kjo që etimologjikisht e ka origjinën nga greqishtja (*σπανοσ*) dhe don të thotë *pa mjekër*.<sup>34</sup> Po t'i referohemi Shuflajt, kjo familje mund të jetë me origjinë greke siç ishte edhe ndonjë familje tjetër si p. sh. *Calogeorgi*.<sup>35</sup> (Kalogeorgi (*καλογεοργος*) don të thotë bujk i mirë – E. M.) Shpanët ishin familje shumë e pasur dhe pasuritë e saj, siç thotë Farlati, në Shqipëri lulëzonin.<sup>36</sup> Në mbështetje të këtij fakti mund të themi që në kadastrën e Shkodrës të vitit 1416-1417 përmenden shumë Shpanë të cilët janë të përhapur gjithkund nëpër rrethinat e Shkodrës dhe ishin pronarë tokash e fshatrash dhe kishin privilegje nga zotërimi venedikas.<sup>37</sup>

<sup>33</sup> P. Petta, *Despotë të Epirit ...*, f. 234.

<sup>34</sup> “*Span*, lat. auch *Ispanus, Yspanus, Adelsfamilie von Drivasto 1400. Vom griechisch. σπανοσ: bartlos ?*” Constantin Jireček, “Die Romanen in den Städten Dalmatiens während des Mittelalters. III. Theil. (Schluss). B) Familien - und Spitznamen aus den altromanischen Städten Dalmatiens in den Jahren 1000-1500”, në: *Denkschriften der Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften. Philosophisch-historische Klasse*. Neunundvierzigster Band. Wien: Carl Gerolds Sohn 1904, f. 61.

<sup>35</sup> Milan Shuflaj, *Serbët dhe Shqiptarët*, përktheu nga kroatishtja Prof. dr. Hasan Çipuri, Tiranë: “Toena”, 2004, f. 16.

<sup>36</sup> “[...] *illustri Genere Spanorum, qui opibus copiisque in Albania florebant.*” *Illyrici Sacri*. Tomus Septimus, Ecclesia Diocletiana, Antibarensis, Dyrrhachiensis et Sirmiensis, cum eorum suffraganeis. Auctore Daniele Farlato, Presbytero Societatis Jesu, et Jacobo Coletto olim ejusdem Societatis alumno. Venetiis, MDCCCXVII. Aput Sebastianum Coleti. Superiorem permissu ac privilegio. (Botim i dytë, Prishtinë: “Arbi”, 2004), f. 85. (më tej: D. Farlato, *Illyrici Sacri*, VII)

<sup>37</sup> Këtu mund të përmendim veçanërisht *Aleks Shpanin* banues në fshatin Bardh (fl. 75/b) *Andrea Shpanin* që mbante prona me koncesion në fshatin Beltojë (fl. 79/b), *Duka (Ducha) Shpanin* që kishte prona në përkatësitë e Shkodrës (fl. 24/a), *Nikollë (Nicola) Shpanin*, që i lë gruas dhe trashëgimtarëve të tij prona në Shkodër (fl. 2/b dhe 149/b), një tjetër *Nikollë Shpani (Nicolaus)*, që kishte prona në përkatësitë e Shkodrës, *Pjetër Shpanin* për të cilin do të flasim pak më poshtë; *Stefan Shpanin* me prona me koncesion në Beltojë (fl. 79/b); një tjetër *Stefan Shpani* që kishte prona edhe në përkatësitë e Shkodrës, pastaj edhe prona të tjera

Një linjë e kësaj familjeje ka qenë në shërbim të venecianëve gjatë shek. XV, kurse një linjë tjetër më parë i përkist përkrahësve të serbëve.<sup>38</sup> Në lidhje me këtë Ippeni dhe Jireçeku përmendin një farë Andreas Shpani (*Andrea Span de Scutaro c. 1330*)<sup>39</sup>, i cili mesa duket ishte një vasal i mbretit serb Stefan Dushani dhe pas vdekjes së këtij bëhet sundues i Drishtit.<sup>40</sup> Shpanët ishin me origjinë nga Shkodra nga ku përmendet edhe një Andreas Span i vitit 1330, ngaqë merreshin me tregti arrijnë të blejnë toka në Drisht, ku mesa duket vendosen atje përfundimisht.<sup>41</sup>

Sipas Brahajit, historikisht selia e Shpanëve ka qenë në Pult, ku edhe sot ruhen rrënojat e kullës, seli të tyre në Selimaj.<sup>42</sup> Pra, diku në krahinën e Dukagjinit ata kishin një pronië, të cilën e kishin marrë fillimisht nga sundimtarët serbë të Zetës.<sup>43</sup> Frang Bardhi në relacionin që bën për krahinën e Pultit në qershor të vitit 1638, kur shkon në Gash na përmend kullën e rrënuar të të birit të Pjetër Shpanit, zotit të Pultit.<sup>44</sup> “*Kjo kullë ishte rrënuar, vetëm dukeshin rrënimet, në disa vende edhe në mur të naltë. Ishte e ndërtime në një thepisje të mrekullueshme, e në të kishte*

me koncesion dhe ishte kreu i fshatrave Bishtërrjollë dhe Karroq (fl. 9/a, 13/b, 19/a, 20/a, etj., etj.). Shih për këtë *Regjistri i Kadastrës dhe i koncesioneve për rrethin e Shkodrës (1416-1417)*, përgatitur për botim nga Injac Zamputi, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Tiranë: 1977.

<sup>38</sup> Konstantin Jireček, “Skutari und sein Gebiet im Mittelalter”, në: *Illyrisch-Albanische Forschungen*. Unter Mitwirkung von Professor Dr. Konstantin Jireček, Professor Dr. Milan von Šufflay, Sektionsschef Theodor Ippen, Professor E. C. Sedlmayr, Archivar Dr. Josef Ivanič, Weiland Emmerich von Karácson, K. Ung. Sektionsrat Béla Péch und Karl Thopia. Zusammengestellt von Dr. Ludwig von Thallóczy. I. Band. Mit einer Landkarte. München/Leipzig: Duncker und Humblot 1916, f. 113.

<sup>39</sup> K. Jireček, “Romanen III ...”, në: *Denkschriften ...*, f. 61.

<sup>40</sup> Theodor Ippen, “Monumente të periudhave të ndryshme në Shqipëri”, në: *Shqipëria e Vjetër. Studime gjeografike, etnografike, historike nga ish-konsulli i përgjithshëm i monarkisë austro-hungareze në Shkodër*, përkthyer nga origjinali: Gjerak Karaiskaj, Ardian Klosi, me riprodhimin e fotografimeve dhe skicave origjinale të Ippenit. Tiranë: K&B, 2002, f. 182.

<sup>41</sup> *Statuta et Ordinationes ...*, f. 47.

<sup>42</sup> Jaho Brahaj, *Emblema Shqiptare (Gjurmime Heraldike)*, Lezhë: Lisitan, 1997, f. 92.

<sup>43</sup> P. Petta, *Despotë të Epirit ...*, f. 233.

<sup>44</sup> Frang Bardhi, “Relacioni mbi Pultin”, në: Tonin Çobani, *Frang Bardhi dhe Relacionet e tij*, Zagreb: Misioni Katolik Shqiptar në Kroaci, 2006, f. 101.

*një kishëz të shën Gjergjit absent*".<sup>45</sup> Aty dy etër minorë observantë reformuar nga Italia, që quheshin Gregor dhe Bernard "*kishin ndërtue e bamë një uratore të bukur dhe të stolisun me kuadro të ndryshme, figure të mëdha dhe të vogla dhe të pastër si të qenkëshin n' Itali*".<sup>46</sup>

Kjo kullë do të ketë qenë pronë e njërit nga Pjetër Shpanët që po përmendim në vazhdim. Si të parin po përmendim Pjetër Shpanin që gjendet në regjistrin e kadastrës dhe të koncesioneve të rrethit të Shkodrës për vitet 1416-1417. Aty është shënuar se ky Pjetër Shpani (*Pier* ose *Pietro*), konsiderohej nga venedikasit si burrë fisnik dhe besnik i zotërimit venedikas që gëzonte privilegje nga Venediku. Këto privilegje i konfirmohen edhe një herë më 10 janar 1416 nga Alban Kontareni, kontkapiten i Shkodrës dhe nga Andrea Fuskolo proveditor dhe përfaqësues i Venedikut në viset e Shqipërisë.<sup>47</sup> Ky Pjetër Shpani ishte proniar i fshatit Dobre (*Dobrea*)<sup>48</sup> dhe i duhej të paguante çdo vit një honorar prej 33 perperësh.<sup>49</sup>

Shpanët krijuan lidhje krushqie më familje të tjera fisnike të fuqishme jo vetëm me shqiptare por edhe me të tjera. Sipas Brahajt, Shpanët kishin lidhje krushqie me perandorin bizantin Teodosi i Madh,<sup>50</sup> por lidhja e Shpanëve me Teodosin e Madh është disi e ngatërruar, sepse Karl Du Fresne, Du Kanxhe (*Carol Du Fresne dominus Du Cange*) e jep këtë lidhje si origjinë e Shpanëve nga ky perandor.<sup>51</sup> Pastaj ata, përsa i përket krushqive, të tilla kishin pasur edhe me Arianitët, Kastriotët dhe Brankoviqët, kishin pasur kontakte të veçanta edhe me osmanët, saqë në një moment të caktuar të luftërave të Skënderbeut, falë këtyre kontakteve ata kishin shërbyer edhe si ndërmjetës midis Venedikut dhe turqve.<sup>52</sup>

Nga kjo familje e ka origjinën Pjetër Shpani tjetër, kanonik i Drishtit (*Petrus Span, can. Drivasten*), i cili më vonë (1423) bëhet kryeipeshkëv i Tivarit.<sup>53</sup> Pjetri ishte aktiv si klerik edhe në Raguzë në Manastirin e Shën

<sup>45</sup> Po aty.

<sup>46</sup> Po aty.

<sup>47</sup> *Regjistri 1416-1417 ...*, fl. 128/ b.

<sup>48</sup> *Po aty*, fl. 38/ a.

<sup>49</sup> *Po aty*, fl. 115/ a.

<sup>50</sup> J. Brahaj, *Emblema ...*, f. 92.

<sup>51</sup> C. Du Cange, *Historia Byzantina duplici Commentario illustrata*, f. 271.

<sup>52</sup> P. Petta, *Despotë të Epirit ...*, f. 233.

<sup>53</sup> "*Petrus Span, can. Drivasten. / 1422 Dec. 14/ Mart. V (Arm.XII,121 p. 156)*". (Eubel, *Hierarchia Catholica I ...*, f. 93) Krahaso edhe: M. Šufflay,

Simeonit, ku në shkurt të vitit 1402 i jepen në përdorim një shtëpi dhe një shtëpizë, të cilat ishin prona të këtij manastiri dhe ndodheshin pranë njëra tjetrës.<sup>54</sup> Ai këto prona mund t'i përdorte gjithë kohën, derisa të qëndronte në Raguzë dhe ishte i detyruar të jepte dy meshë në javë për të në kishën e manastirit në fjalë.<sup>55</sup> Gjatë kohës që ai qëndronte në Raguzë, më saktë, më 22 mars të vitit 1400, ai përmendet edhe si dëshmitar i betuar në testamentin e një prifti shqiptar me emër Dom Lazër Albanezi (*dompnus Laçari Albanensis*), i cili vdes dhe varroset po në Raguzë.<sup>56</sup>

Një përfaqësues tjetër i kësaj familje, i cili përmendet edhe në librat e arkivave të Raguzës një person po me emrin Pjetër Shpani (*Peter Spán*), 1430-1456 (ose † para vitit 1458), që ishte shqiptar katolik,<sup>57</sup> d.m.th jo ortodoks dhe jo sllav, edhe pse bijtë e tij siç e shohim më poshtë i kanë emrat të shkruar në versionin sllav. Ai kishte pra tre bij, Bozhidarit (*Božidar*) († para vitit 1474), Aleksin (*Alexius filius Petri Spani* = Aleks, i biri i Peter Shpanit – E. M.) ose të quajtur ndryshe edhe Llesh Shpanoviqin (*Lješ Spanović*), i cili në vitin 1454 ka qenë vojvodë i despotit Gjergj (Georg) në qytetin malor të Novo Bërdës (Lleshi në vitin 1474 ka qenë gjallë akoma) dhe biri i fundit i Pjetër Shpanit quhej Hërvoje (Hrvoje) që në vitin 1478 ishte akoma gjallë.<sup>58</sup> Ky Pjetër Shpani mori pjesë edhe në Lidhjen e Lezhës në vitin 1444.<sup>59</sup> Në vitin 1474 paraqiten edhe i biri i Bozhidarit, Pjetri me nënën e tij Gojsavën dhe gruan e tij Ljubosavën.<sup>60</sup> Sipas Jirečekut, kjo derë mesa duket në shek.

---

“Kirchenzustände”, në: *Forschungen I*, f. 246. Shih edhe tek D. Farlati: “*Hunc Martinus V. ad Sedem Archiepiscopalem evexit, ut est in tabulis Consistorilibus: 19 Januarii 1423. provimit de persona D. Petri Span, Canonici Ecclesiae Drivastensis, Ecclesiae Antubarensi vacanti per declarationem factam per Dominum nostrum ec.*” Farlato, *Illyrici Sacri VII*, f. 85.

<sup>54</sup> *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek. XV. (1400-1405)*, I, përgatitur nga Injac Zamputi dhe Luan Malltezi, redaktor përgjegjës Aleks Buda, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Tiranë: 1987, nr. 189.

<sup>55</sup> *Po aty*.

<sup>56</sup> *Po aty*, nr. 10.

<sup>57</sup> K. Jireček, “Skutari ...”, në: *Forschungen I...*, f. 113.

<sup>58</sup> *Po aty*.

<sup>59</sup> *Statuta et Ordinationes*, f. 47.

<sup>60</sup> K. Jireček, “Skutari ...”, në: *Forschungen I...*, f. 113.



XVI kishte një degë të sajën (*Spanich*) në Kurzola të Dalmacisë dhe një në Shibenik.<sup>61</sup>

Sipas Pettës, Spanët patën mosmarrëveshje për një farë kohe me venedikasit dhe më vonë patën kontakte të veçanta edhe me osmanët dhe falë këtyre lidhjeve, gjatë luftërave të Skënderbeut, krijuan herë pas here kontakte të fshehta ndërmjet venedikasve<sup>62</sup> dhe osmanëve,<sup>63</sup> “dhe më vonë premtuan të nxisnin një revoltë të komandantëve turq të Moresë dhe të frytëzonin mirëkuptimin me ta, për t’i shkuar në ndihmë Krujës së rrethuar”.<sup>64</sup> Sipas të dhënave Skënderbeu u bën thirrje venedikasve në vitin 1466 që të merrte në mbrojtje djemtë e Pjetër Shpanit, megjithatë njëri prej tyre Aleks, kaloi atje shumë vite më vonë më 1491, disa vite para vdekjes së tij më 1495.<sup>65</sup> Pjesëtarë të kësaj familjeje ikën në Itali pas pushtimit turk, një pjesë tjetër duket se u shpërnda në brendësi të vendit,<sup>66</sup> kryesisht në Venedik.

Degrad, si për Engjëllorët, na jep edhe një gjenealogji edhe për Shpanët. Kjo gjenealogji paraqet anëtarët e njëres degë të kësaj familje duke filluar nga fundi i shekullit të XIV duke vazhduar deri në gjysmën e dytë të shek. XV. Sipas kësaj gjenealogjie fisi Shpani ndahej në dy degë. Në të parën përmenden vetëm dy përfaqësues Marini († para vitit 1409) dhe i biri Pjetër por kjo degë shuhet,<sup>67</sup> dhe për këtë jemi të mendimit që ky Pjetri ishte kleriku katolik dhe kanoniku i lartpërmendur i Kishës së Drishtit i cili në vitin 1423 nga papa Martini V emërohet arqipeshkëv i Tivarit.<sup>68</sup> Kurse dega tjetër ka vazhdimësi dhe po e japim më poshtë si vijon.<sup>69</sup>

Brezi I: Ajo fillon me Stamat Shpanin, të dokumentuar në vitin 1382.

Brezi II: I biri i Stamatit ishte Andrea që kishte tre bij dhe përfiton edhe pronat e një personi të quajtur Pjetër të cilësuar si tradhtar nga pushteti venedikas.

<sup>61</sup> K. Jireček, “Romanen III ...”, në: *Denkschriften ...*, f. 61.

<sup>62</sup> S. Ljubić, *Listine X ...*, nr. CCLXXXV.

<sup>63</sup> P. Petta, *Despotë të Epirit ...*, f. 233.

<sup>64</sup> *Po aty*.

<sup>65</sup> *Po aty*, f. 233-234.

<sup>66</sup> J. Brahaj, *Emblema ...*, f. 92.

<sup>67</sup> A. Degrand, *Souvenirs de la Haute-Albanie ...*, pa numer faqeje.

<sup>68</sup> D. Farlato, *Illyrici Sacri VII*, f. 85.

<sup>69</sup> Të gjitha të dhënat për gjenealogjinë e Shpanëve të paraqitur këtu janë marrë nga: A. Degrand, *Souvenirs de la Haute-Albanie*, pa numer faqeje.

Brezi III: Bijtë e Andreas ishin Nikolla (Nicolo 1407 † 1418), Iakne dhe Stefani (1407 † 1439).

Brezi IV: Nga këta të tre bij të Andreas ka pasardhës vetëm Nikolla dhe ata janë Mikeli besnik i venedikasve (1418-1442), Stefani (1418 që rebelohet në vitin 1442), Nikolla (Nicolo që rebelohet në vitin 1442), Stefani dhe Nikolla në gjenealogji nuk jepen se kanë pasardhës, të tillë ka vetëm Mikeli.

Brezi V: Të bijtë e Mikelit janë Aleks (1442 † ?), Andrea (1442 † ?) që kishte një vajzë të martuar në Hungari, por që nuk i jepet emri, Pjetri (Pietro 1442 † ?), Pali (Paolo 1442 † ?), Mikeli (1442 † ?) Gjoni (Giovanni 1442 † ?), Simioni (1442 † ?), Martini (1442) dhe e bija Anjeza (Agneze). Nga gjithë këta në gjenealogji janë të paraqitur vetëm fëmijët e Aleksit.

Brezi VI: Pasardhësit e Aleksit janë Mario, Biagio (Biagio), Aleksandri (Alesandro), Luçia (1470 † 1478), Demetria Angelina, Adriana. Nga këta janë paraqitur pasardhës vetëm për Biagjin.

Brezi VII: Pasardhësit e Biagjit janë Kornelia (Cornelia) dhe Marku (Marco). Marku jepet me një pasardhës që është Aleks

Brezi VIII: Aleks (Alessi) i biri i Markut.

Përveç këtyre dy degëve që përmendëm më sipër mesa duket ekzistonte dhe një degë tjetër gjenealogjinë e së cilës na e jep studiuesi Karl Du Fresne, Du Kanxhes (Carol Du Fresne dominus Du Cange) në veprën e tij "*Historia Byzantina duplici Commentario illustrata*". Këtë gjenealogji po e japim më poshtë<sup>70</sup>:

Brezi I: Andreas, princ i Drishtit, i vekur në vitin 1366, që ishte i ati i Mihaelit (Pjetrit) dhe Irenës.

Brezi II: Mihaelit, i biri i Andreas quhej nga të tjerët edhe Pjetër, dhe që sipas kësaj gjenealogjie, është i pari që merr mbiemrin Shpani. Gruaja e këtij ishte Agneta, e bija e zotit të Pogut dhe e motra e Vojsavës, nënës së Skënderbeut.

Brezi III: Bijtë e Mihaelit ishin Andrea Shpani (Andreas Spanus), Dukë dhe administrator (comes) i Drishtit, dhe Aleks Shpani (Alexius Spanus). Andrea Shpani ishte i martuar me Agnetën, të bijën e Arianit

---

<sup>70</sup> Të gjitha të dhënat e kësaj gjenealogjie janë marrë nga: C. Du Cange, *Historia Byzantina duplici Commentario illustrata*, f. 272.

Kommenit, kurse Aleks Shpani qe i martuar me Milicën, të bijën e Gjergj Brankoviçit, despotit serb.\*

Brezi IV: Në këtë brez jepen vetëm bijtë dhe bijat e Aleks Shpanit që ishin: Aleksandër Shpani (Alexander Spanus) i martuar me Elizabet de Moloria, fisnike e Pavidias; Mark Shpani (Marcus Spanus) i martuar me Nikole Brianan (Nicola Briana), fisnike venedikase; Vlash Shpani (Blasius Spanus) i martuar me Katerina Kontarenën (Catarina Contarena), të bijën e Sigismunidit, fisnik venedikas; pastaj më tej bijat: Angjelina, e martuar me Stefanin Dukën e Pollogut; Adriana, e martuar me Johannes Michaelis, fisnik venedikas; dhe Luçia, e martuar me Pjetër Engjëllin, Dukë i Drishtit. Tek ky brez bie në sy numri i madh i fëmijëve që ishin gjashtë.

Brezi V: Në këtë brez janë i biri i Aleksandër Shpanit që quhet Mark Shpani (Marcus Spanus), që ishte i martuar me Katarina de Ferraris, fisnike padoveze dhe më tej: e bija Vlash Shpanit, Korneli, e martuar me Johan Paulon (Johanni Paulo).

Brezi VI: Në këtë brez është vetëm Aleks Spani (*Aleksius Spanus*) i biri i Markut dhe i Katerinës.

Një familje tjetër me rëndësi në Drisht ishte edhe familja *Ungri* (*Ungaro ose Hungarus*), e cila me sa duket ishte me origjinë nga Kotorri, por ndoshta edhe nga ndonjë qytet tjetër dalmatin. <sup>71</sup> Megjithatë, meqë familja Ungri është shumë e pranishme jo vetëm në Drisht por edhe në distriktin e Shkodrës, ka shumë mundësi që të jetë edhe vendase. Prej kësaj familje vinte Pal Ungri (*Paulus Ungaro*), fisnik i Drishtit (*Nobilis de Drivasto, 1403*), i cili qe nderuar me medalje dhe më 7 maj 1403 kishte përfituar bile edhe lehtësime, sepse kishte marrë pjesë në luftën kundër osmanëve bashkë me tërë familjen dhe kishte vënë në dispozicion të gjithë kuajt. <sup>72</sup>

---

\* Andrea Shpani ka të shënuar përpara numrin 1, kurse Aleks Shpani ka të shënuar numrin 2, dhe pas Aleks Shpanit pasojnë edhe emrat me numrat 2. Petrus. 2. Paulus. 2. Michael. 2. Johannes. 2. Hermon. 2. Martinus. 2. Agnes, kuptimin e të cilëve nuk e dimë. Pra nuk jepet e qartë nëse këta emra janë fëmijët e Mihaelit, apo të Aleksit, apo diçka tjetër. *Po aty*.

<sup>71</sup> Branislav Millutinoviç, "Drishti nën sundimin e Venedikut", në: *Gjurmime Albanologjike*, Seria e shkencave historike, 15-1985, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë: 1986, f. 47.

<sup>72</sup> *Po aty*.

I biri i tij ishte me sa duket Belaco Ungri ( *Bellazzo* ose *Bellacisu Ungaro*), që pati shumë merita për kalimin e Drishtit dhe të Tivarit nën sundimin venedikas.<sup>73</sup> Atij si shpërblim më 1443 iu fal fshati *Gastropoti* dhe më vonë emërohet *vojvodë i Drishtit* dhe përfaqësonte qytetin e tij në Venedik që prej 20 korrikut 1446.<sup>74</sup> Pas vdekjes së tij Venediku emëron birin e tij Nikollën<sup>75</sup> si vojvodë të Drishtit, i cili më vonë vritet duke luftuar me trimëri mbi muret e qytetit, kundër rrethimit të turqve.<sup>76</sup> Një pinjoll i kësaj familje ishte edhe Marino Ungaro, që përmendet në vitet 1508-1514 si rektor i juristëve në Universitetin e Padovës.<sup>77</sup>

Në lidhje me familjen **Suma (Summa)**, të cilën mund ta rreshtojmë ndër familjet kryesore të Drishtit, mund të themi që ajo ishte një nga familjet e vjetra vendase të Shqipërisë veriperëndimore, të cilat luajtën një rol në zhvillimin e ngjarjeve në Shqipërinë e shek. XV.<sup>78</sup> Së pari, po përmendim këtu një klerik drishtjan emri i tij nuk na bëhet i ditur, porse ai ishte prej kësaj familje. Ai ishte bërë ipeshkëv i Shkodrës, dhe nuk pranonte t'ia lëshonte këtë post ipeshkëv legjitim që ishte emëruar nga Papa në vitin 1368.<sup>79</sup> Mbase këtu bëhet fjalë për një farë Antonius, i cili qe ipeshkëv i Shkodrës që nga viti 1367 e në vazhdim.<sup>80</sup>

Nga pinjollë të tjerë të kësaj familje mund të përmendim këtu Dhimitër Sumën (*Demetrius Summa*), i cili së bashku me fisnikë të tjerë lokalë ngriti krye kundër Stefan Dushanit, pasi ky nuk ishte treguar

<sup>73</sup> *Statuta et Ordinationes ...*, f. 48.

<sup>74</sup> *Po aty*.

<sup>75</sup> "*vidua Nicolai Ongaro condam vojvode de Drivasto*". Milan von Šufflay, *Städte und Burgen Albaniens hauptsächlich während des Mittelalters*. Vorgelegt in der Sitzung am 24. April 1918. Kommissions-Verleger der Akademie der Wissenschaften in Wien. Wien/Leipzig: Hölder-Pichler-Tempsky A.-G. 1924, f. 54.

<sup>76</sup> "*Cum Civitas nostra Driuasti a Turcis obsideretur Nicolaus hungarus olim Vayuoda loci illius supa urbis menia acriter pugnans, tandem ab hostibus occisus est.*" *Dokumenta të shekullit XV për historinë e Shqipërisë 1479 – 1506*, Pjesa II (1499 – 1506), përgatitur nga Injac Zamputi, Akademia e Shkencave të RPSSH, Tiranë: 1979, nr. 33.

<sup>77</sup> Lucia Nadin-Bassani, *Migrazione e intergrazione: il caso degli Albanesi a Venezia (1479-1552)*, Roma: Bulzoni, 2008, f. 93.

<sup>78</sup> Oliver Jens Schmitt, *Das venezianische Albanien (1392-1479)*, München: Oldenburg 2001 (Südosteuropäische Arbeiten 110. Für Südost-Institut München Hrsg. v. Edgar Hösch und Karl Nehring.), f. 87.

<sup>79</sup> M. Šufflay, "Kirchenzustände", në: *Forschungen I*, f. 246.

<sup>80</sup> D. Farlato, *Illyrici Sacri VII*, f. 304.

shumë mirënjohës ndaj përkrahësve të tij lokalë, në kohën kur po i bënte një grusht shteti të atit të tij, për t'i marrë fronin.<sup>81</sup> Kjo kryengritje që plasi në mesin e shek. XIV, u shtyp nga Stefan Dushani.<sup>82</sup> Këtu mund të shtojmë që ndër predikuesit e kryqëzatës të periudhës 1455-1458, të organizuar nga Papa Kaliksti III, përmendet edhe Ati Françeskan nga Drishti, Euxhenio Summa, i cili ishte predikues i thjeshtë dhe në kohën e Papë Nikollës V, që emëruar nunc, kurse nga Kaliksti III iu dhanë të drejta të shumta.<sup>83</sup> Nga kjo familje doli në vitin 1457 edhe një ipeshkëv i Drishtit, i quajtur Nikollë Suma (*Nicolaus de Summa*), i cili u bë edhe rektor i kishës së pjesës së vjetër të Drishtit (mbase bëhet fjalë këtu për kishën *Sancta Maria Veteris*), që në fakt ishte pjesë e arqipresbiteratit të kishës së Drishtit.<sup>84</sup> Në Shkodër sot ka disa familje me mbiemrin Suma, dhe mendoj se ato mund të jenë pasardhëse e Sumëve të Drishtit.

Një tjetër familje me rëndësi ishte edhe ajo me mbiemrin *Lepore (de Leporibus)*. Prej kësaj familje vinte edhe një person tjetër me emrin Gjon që ka qenë ipeshkëv i Drishtit (*Johann de Lepore*) nga viti 1360 deri në vitin 1373 (sipas Shuflajt dhe Novakut që ipeshkëv gjatë kohës 1359-1389)<sup>85</sup>. Më pas papa Gregori XI e transferoi atë më 18 maj 1373 në arqipeshkvinë e Tivarit,<sup>86</sup> pasi arqipeshkvi i atyshëm, i quajtur edhe ky Gjon (Johannes) që mesa duket ishte nga Raguza, ishte problematik. Kështu Papa në korrik të vitit 1371, e hoqi nga posti i arqipeshkvit dhe

<sup>81</sup> O. Schmitt, *Das venezianische Albanien*, f. 87.

<sup>82</sup> *Po aty*.

<sup>83</sup> G. Valentini, "Shtojcë D. Lista e predikuesve të kryqëzatës", në: M. Sciambra/ G. Valentini/ I. Parrino, *Papa Kaliksti III, Skënderbeu, Shqipëria dhe Kryqëzata (1455-1458)*. Tiranë: Plejad, 2009 (= Plejada e Mendimit albanologjik. Seria "Valentini"), f. 259-260.

<sup>84</sup> "*Nicolaus de Summa, can. Drivasteins. ... et rector paroch. eccl. de Drivasto veteri, quae ei remanet in comm. unaeum archipresbyteratu ecc. Drivasten.*" C. Eubel, *Hierarchia catholica II*, f. 145, ref. 2.

<sup>85</sup> *Statuta et Ordinationes ...*, f. 61.

<sup>86</sup> "*Joannes de Leporibus (Andreae), ep. Drivasten./ 1373 Maii 18/ Gre. XI a. 3 (t. 272) f. 133*". *Hierarchia Catholica Medii Aevi sive Summorum Pontificium, S. R. E. Cardinalium, Ecclesiarum Antistitum series. Ab anno 1198 usque ad annum 1431 perducta. E documentis Tabularii praesertim Vaticani collecta, digesta, edita per Conradum Eubel, S. Theol. Doct. Ord. Min. Conv. Definitorem Generalem olim Apostolicam apud S. Petrum de Urbe Poenitentiarum. Editio altera. Sumptibus et Typis Librariae Regensbergianae. Monasterii MDCCCXIII*, f. 93. *Shih edhe: D. Farlato, Illyrici Sacri VII*, f. 237.

për dënim në vitin 1373 e kishte transferuar për në Palestinë, në Cezarea (Kaisarije).<sup>87</sup> Mirëpo Gjoni nuk pranoi të ikte dhe qëndroi në Tivar, kështu që Papa thirri për ndihmë zotërinjtë e Zetës dhe Karl Topinë.<sup>88</sup> Ky ipeshkëv ishte i lidhur shumë me Balshajt.<sup>89</sup>

Një person tjetër i njohur i kësaj familjeje ka qenë Teodori i Drishtit (*Teodorus de Drivasto*) i cili qe ndihmës i Dominik Topisë (xhaxhait të princit të njohur, Karl Topisë) që u mundua të bëhej arqipeshkëv i Raguzës dhe që ishte shumë aktiv në instalimin e urdhrit domenikan në trojet shqiptare dhe në ndërtimin e kuvendeve domenikane në Shkodër, Kotorr dhe Shibenik dhe që në vitin 1367 u bë arqipeshkëv i Zarës.<sup>90</sup> Teodori që njihej si ndihmës dhe përkrahës i domenikanit Dominik Topia u dëbua nga qeveria e Raguzës, porse me kërkesën e Balshajve, këshilli i lartë i Raguzës më 4 maj 1361 i lejoi atij që të qëndronte atje edhe katër muaj, me arsyetimin se atij i duhej të mblidhte borxhet që i kishin qytetarët e atjeshëm.<sup>91</sup> Teodori kishte lidhje gjaku me ipeshkvin e Drishtit, Gjoni që përmendëm pak më lart.<sup>92</sup>

Ndër familjet më të vjetra të krahinave të Drishtit po përmendim këtu edhe *Mazrit* apo *Mazrekët*, emrin e të cilëve e mbante edhe një fshat në Postrinë, që mesa duket ishte formuar nga përqendrimi i tyre. Ky fis na intereson edhe për faktin, sepse sipas Zef Valentinit, prej këtij e ka origjinën edhe Skënderbeu, ngaqë Kastriotët, e kishin zakon të vendosnin krahas mbiemrit Kastriot, edhe mbiemrin Mazreku.<sup>93</sup> Mbiemrat Kastrioti dhe Mazreku të vendosura njëri pas tjetrit i hasim tek autori Du Kanxhe, i cili përmend stërgjyshin e Skënderbeut, Kostantin Kastriot Mazrekun († 1390) dhe e cilëson atë si princ të Matit dhe të Kastorias.<sup>94</sup>

<sup>87</sup> "Joannes O. Praed., prior domus Ragusin. .../ tr. Jo. ad Caesariem". Eubel, *Hierarchia Cattolica I*, f. 93. Shih edhe: M. Šufflay, "Kirchenzustände ...", në: *Forschungen I* ..., f. 246.

<sup>88</sup> M. Šufflay, "Kirchenzustände ...", në: *Forschungen I* ..., f. 247.

<sup>89</sup> M. Šufflay, *Städte* ..., f. 52.

<sup>90</sup> *Statuta et Ordinationes* ..., f. 60-61.

<sup>91</sup> "[...]quod Theodorus de Leporibus de Drivasto possit stare in Ragusa ad exigendum debita sua". *Po aty*, f. 61.

<sup>92</sup> *Po aty*.

<sup>93</sup> G. Valentini, "Kastriotët ...", në: M. Sciambra, G. Valentini, I. Parrino, *Papa Kaliksti III* ..., f. 35.

<sup>94</sup> "Constantinus Castriotus, cognomento Meserechus, Æmathie & Castorie Princeps, vel Dominus, memoratur a Flavio Comneno, quam Obiisse ait anno

Sipas Valentinit, “Kastriotët kanë kenë pa dyshim asi mazrekësh, por rrjedhë fill nga dera ma e para, kasa lëndoheshin si bujarë, Mazrek tue kenë me gjithë të drejtë”.<sup>95</sup> Paolo Petta shkruan se në një burim të datës 8 tetor 1467, që është “*Genealogia diversarum principum familiarum mundi*”<sup>96</sup> me autor Xhovani Andrea Engjëllin (*Giovanni Andrea Angelo Flavio Comneno*), përmendet edhe emri Gjergj Mazrek Kastriot Skënderbeu<sup>97</sup>, emër ky që përsëritet edhe në burime të tjera. Pra, këtu del në pah lidhja e Kastriotëve me Mazrekët dhe identifikimi i Skënderbeut me këtë farefis, ngaqë për të përdoren të dy mbiemrat *Mazreku* dhe *Kastrioti*.<sup>98</sup>

Sipas Valentinit, këta Mazrekë, u shpërngulën dhe u shpërndanë anekënd Shqipërisë deri në Qerfoz e deri në fund të Moresë, dhe çdo vendi, në të cilin nguleshin ia ngjisnin emrin Mazrek.<sup>99</sup> Një degë e tyre duket se u vendos edhe tek arbëreshët e Sicilisë.<sup>100</sup> Fshati i tyre Mazrek

MCCCXC”. C. Du Cange, *Historia Byzantina duplici Commentario illustrata ...*, f. 270.

<sup>95</sup> G. Valentini, “Kastriotët ...”, në: M. Sciambra, G. Valentini, I. Parrino, *Papa Kaliksti III ...*, f. 35.

<sup>96</sup> Titulli i plotë e kësaj vepre është: “*Genealogia diversarum principum familiarum mundi incipiendo ab Adamo: et continuando per lineam rectam masculinam à patre ad filium usque ad videlicet à Cam tantummodo filio secundo Noe. Et precipue familiae Carlingæ, de Angiò, de Valois, de Borbon, Meroveiæ Austriacæ, Saxonæ, Sabaudia, Gonzagæ, Pia, Picæ, Ursinæ, Atestinæ, & familiae. Angelæ Flavie Comnenæ, sive Silvie deinde Amiliæ. Justinianæ, Vicecomitis, Turianæ, Acciaiola, Montisfeltrii, Cossazzæ: Cernovicchiæ: Ducaginæ, & Castriotæ. In lucem edita per Jo. Andream Angelum Flavium Connenum*” Në lidhje me këtë gjenealogji të këtij Engjëllori, Petta shprehet më tej se “sado që bëhet fjalë për një burim krejt të pabesueshëm, nuk mund të mos vihet në dukje se përsa i përkey gjenealogjive shqiptare, Engjëllorët (të cilët formonin një “dinasti” të vërtetë falsifikuesish të gjenealogjive) zotërojnë herë-herë të dhëna të sakta”. P. Petta, *Despotë të Epirit ...*, f. 152, ref. 40.

<sup>97</sup> G. A. Angelo Flavio Comneno, *Genealogia diversarum principum familiarum mundi*, Venezia, 1621, f. 25. P. Petta, *Despotë të Epirit ...*, f. 152, ref. 40.

<sup>98</sup> P. Petta, *Despotë të Epirit ...*, f. 14.

<sup>99</sup> G. Valentini, “Kastriotët ...”, në: M. Sciambra, G. Valentini, I. Parrino, *Papa Kaliksti III ...*, f. 35.

<sup>100</sup> Po aty. **Shënim:** Në lidhje me historinë e këtij fisi pas emigrimit në Itali nuk kemi të dhëna, por Paolo Petta shkruan se në gusht të vitit 1509 mbërritën në Venedik kalorës shqiptarë nga viset e Shkodrës, që ishin veshur sipas mënyrës turke

në afërsi të Drishtit ishte në Mesjetën e Vonë pronë e Engjëllorëve dhe quhej Masora (në gjuhën venedikase Maiora).<sup>101</sup> Në lidhje me Kastriotët e Drishtit kemi të dhëna edhe më vonë, në shek. XVII, kur dalin nëpër dokumente dy emra që janë Pjetër Kastrioti dhe e bija Ana Katerina Kastrioti.<sup>102</sup> Emra të tjerë nga kjo familje nuk kam mundur të gjej. Paolo Petta është i mendimit, që lidhjet e Mazrekëve me Kastriotët, konfirmohen jo vetëm nga burime që herë herë janë të dyshimta, por edhe nga tradita gojore që ruhet ende tek fisi Mazrek që ndodhet sot Shqipërinë Veriore.<sup>103</sup>

Nga ky farefis sot mund të përmendim edhe Dom Nikollë Mazrekun, klerik katolik, historian dhe shkrimtar, i cili për Skënderbeun ka shkruar edhe një roman voluminoz prej 800 faqesh me titull “*Me flamujt e Kastriotvet*”<sup>104</sup>, që pa dritën e botimit në fund të vitit 2012, gjashtëmbëdhjetë vjet pas vdekjes së tij. Në këtë roman autori ruan traditën që Kastriotët janë me origjinë nga Mazrekët.<sup>105</sup> Në lidhje me këtë farefisni, Petta shprehet më tej, se “*bëhet fjalë për një fis të madh, ku bënin pjesë barinj të shtegtarë ‘të pambrret’ (abasileutoi), të cilët historianët bizantinë i përmendin në Thesali në gjysmën e parë të shek. XIV, si dhe njësitet luftarake që nga fundi i atij shekulli luftuan kundër Tokove në Greqinë veriperëndimore*”.<sup>106</sup> Sipas Pettës, por edhe sipas Çabejt, emri “Mazrek” etimologjikisht shpjegohet me rritës kuajsh.<sup>107</sup>

Familja **Bel**, **Belli**, **Belle**, **Bei** që përmendëm më sipër, sipas Jireçekut, ishte po ashtu familjeje fisnike nga Drishti, e cila ka ekzistuar

dhe që thonin se mbanin emrin e lashtë e të mirënjohur të Skënderbeut, dhe se në kronikat e mëvonshme bëhet shpesh herë fjalë për një kapiten me emrin Skënderbe, i cili mund t’i përkiste këtij grupi. P. Petta, *Despotë të Epirit ...*, f. 148.

<sup>101</sup> G. Valentini, “Kastriotët ...”, në: M. Sciambra, G. Valentini, I. Parrino, *Papa Kaliksti III ...*, f. 34.

<sup>102</sup> P. Petta, *Despotë të Epirit ...*, f. 233.

<sup>103</sup> *Po aty*, f. 147.

<sup>104</sup> Dom Nikollë Mazrreku, *Me flamujt e Kastriotvet*, Roman historik, Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë: 2012.

<sup>105</sup> Autori në këtë roman Kastriotët i jep me prejardhje nga Mazrekët, nga dega e tyre që ndodhet tek Kastratët e Pusit të Thatë në Pashtrik. *Po aty*, f. 791.

<sup>106</sup> *Po aty*, f. 147-148.

<sup>107</sup> *Po aty*, f. 152, ref. 43.



midis shekujve XIV-XV.<sup>108</sup> Sipas Shuflajt mbiemri i kësaj familje është element i pastër latin, pra supozohet që ajo e kishte origjinën nga paraardhës romakë.<sup>109</sup> Megjithatë duhet të themi që mbiemri *Bel*, në sllavisht do të thotë i *bardhë*. Si pjesëtar të saj na përmenden në dokumente Pali, i biri i Gjergj Belit (*Paulus filius Georgii Belli in Drivasto 1365-1369*) dhe *Paulus Bei de Driuasto*.<sup>110</sup> Më tej, në lidhje me pjesëtarë të tjerë të kësaj familjeje hëpërhë nuk kemi të dhëna.

### **Familje të tjera fisnike të Drishtit, të një rëndësie më të vogël**

Në këtë pjesë të dytë të artikullit kam menduar të paraqes të dhëna mbi disa familje të tjera drishtjane që kanë një farë rëndësie, gjenden edhe nëpër dokumente, por mbi fisnikërinë e tyre nuk ka dëshmi të mjaftueshme. Familje të tilla ishin *Skepudar*, *Zogi*, *Svinis*, *Sporo*, *Tossil*, dhe *Manganja*. Po e nis me *Skepudarët*.

Në lidhje me familjen *Schepudar*, nga llagapi i së cilës duket se e ka origjinën edhe etnonimi “shqiptar”, mund të themi që ajo përmendet për herë të parë në Drisht në vitin 1368, si mbiemër familjar<sup>111</sup> dhe konsiderohet si gjurma e parë e emrit të popullit shqiptar.<sup>112</sup> Në lidhje me këtë familje na përmendet një presbiter i quajtur Pjetër Skepudari, kanonik i Drishtit (*Presbyter Petrus Schepudar, Canonicus Drivastensis*)<sup>113</sup> i cili më 11 dhjetor 1368 merr nga priftërinjtë Marini dhe Pashku një libër meshe (meshar), të cilin do t’ia dërgonte kishës

<sup>108</sup> “*Bel, Belli, Belle, Nobiles von Drivasto im XIV.-XV. Jahrhundert*”. Constantin Jireček, “Die Romanen in den Städten Dalmatiens während des Mittelalters. III. Theil. (Schluss). B) Familien - und Spitznamen aus den altromanischen Städten Dalmatiens in den Jahren 1000-1500”, në: *Denkschriften der Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften. Philosophisch-historische Klasse*. Neunundvierzigster Band. Wien: Carl Gerolds Sohn 1904, f. 6.

<sup>109</sup> M. Shuflaj, *Serbët dhe Shqiptarët ...*, f. 16.

<sup>110</sup> “*Paulus filius Georgii Belli in Drivasto 1365-1369 Deb. Rag.; Paulus Bei de Driuasto*.” K. Jireček, “Romanen III”, në: *Denkschriften ...*, f. 25.

<sup>111</sup> O. Schmitt, *Das venezianische Albanien ...*, f. 51, ref. 59.

<sup>112</sup> Pëllumb Xhufi, *Dilemat e Arbërit. Studime mbi Shqipërinë mesjetare*. Tiranë: Pegi, 2006, f. 27.

<sup>113</sup> *Po aty*.

katedrale të Shën Marisë në Drisht<sup>114</sup>, së cilës duket se i përkiste si kanonik. Më 21 qershor 1392 në dokumente paraqitet një person tjetër me këtë llagap, i quajtur Pjetër Andrea Skepudari (*Petro Andrea Schepudar*), i cili i blen Gjonit III, ipeshkvit të Drishtit të ardhurat (duke përfshirë të korrat dhe të vjelat) vetëm për një vit, për 40 dukatë ari.<sup>115</sup> Mbase në këto dy dokumente bëhet fjalë për të njëjtin person edhe pse distanca kohore prej 24 vitesh midis këtyre dy dokumenteve është mjaft e gjatë.

Edhe familja **Zogi, Çoghi ose Zogy**, duket ishte nga Drishti dhe nga kjo familje mund të përmendim zotin *Petro Leporo* të birin e njëfarë Nik Zogi nga qyteti i Drishtit (*Dompno Petro Lepporo f. q. Nic. Çoghi de civitate Drivasti*) që përmendet në vitin 1402.<sup>116</sup> Pjesëtarë të kësaj familje apo familje të tjera po me të njëjtin emër duket se ka pasur edhe në Ulqin e Tivar. Nga këto dy qytete mund të përmendim Markon, të birin e Zotit Vita de Zogi (*Marcho f. de Ser Vita de Z.*) i cili përmendet në një letër nga qyteti i Ulqinit në vitin 1380 dhe nga Tivari është (*Petrus q. Zogy de Antibaro*), i cili përmendet po ashtu në vitin 1380.<sup>117</sup>

Një familje tjetër është edhe ajo e quajtur **Svinis (Suignis)** që haset disa herë nëpër dokumente historike që kanë të bëjnë me Drishtin. Etimologjikisht, sipas Shuflajt, Jirečekut dhe Talloscit ky mbiemër vjen nga fjala sllave *svinja* që don të thotë *thi, derr*. Mesa duket kjo familje ka një origjinë sllave. Por duhet të përmendim këtu që fjala *Suinis* edhe në latinisht ka lidhje me fjalën *thi derr* (*suinis* = mbiemër gjinia fem., rasa

<sup>114</sup> *Acta et Diplomata res Albaniae Mediae Aetatis illustrantia*. Collegerunt et digesserunt Dr. Ludovigus de Thallóczy, Dr. Constantinus Jireček ed Dr. Emilianus de Sufflay. Volumen II (Annos 1344-1406 conteniens) (Nr. 555 et passim) Vindobonae MXMXVIII. Typis Adophi Holzhausen, nr. 252.

<sup>115</sup> "1392, 21 iunii. Ragusii. Nos Johannes, dei apostolice sedis Gratia episcopus Drivastensis, confitemur, quod omnes fructus, redditus et proventus episcopatus nostri predicti Drivastensis anni solummodo dedimus, vendidimus et cessimus domino Pedro andrie Schipudar de Drivasto presenti et ementi pro ducatis quadraginta pro parte solutis, quia confitemur recepisse ab eo triginta ducatos auri et residuum nobis dare debet illico in reversione nostra de presenti viago quod faciam....", AAlb II, nr. 482.

<sup>116</sup> "Zogi. 1) *Dompno Petro Lepporo f. q. Nic. Çoghi de civitate Drivasti 1402 Div. Rag.*" K. Jireček, "Romanen III ...", në: *Denkschriften ...*, f. 70.

<sup>117</sup> "2) *Marcho f. de Ser Vita de Z. in einem Brief aus Dulcigno 1380 Lett. e Comm. 1359-1380 f. 135.* 3) *Petrus q. Zogy de Antibaro 1380 L Ref.*" K. Jireček, "Romanen III ...", në: *Denkschriften ...*, f. 70.

gjinore). Emrat që përmenden në lidhje me këtë familje janë Jakob Svini i Drishtit (*Jacopus de Svinis Drivastensis*)<sup>118</sup> që ishte presbiter në Raguzë dhe Pjetër Svini i Drishtit (*Petrus de Svinis Drivastensis*) po ashtu presbiter në Raguzë në vitin 1391, i cili me ndihmën e bashkatdhetarit të tij Andrea i Durrësit (*Andrea de Duracio*), që ishte arqipeshkëv i Raguzës dhe prior i urdhrit dominikan për provincën e Dalmacisë, bëhet prokurator i vëllazërisë së dominikanëve në Raguzë.<sup>119</sup> Megjithatë Jireček e bën të pranishme këtë familje fisnike edhe në Ulqin.<sup>120</sup>

Kurse në Shkodër dhe në disa fshatra të saj na del një formë tjetër e këtij mbiemri Svinci ose Suinci dhe pjesëtarë të këtij fisi i gjejmë të regjistruar në Kadastrën e Koncesioneve për rrethin e Shkodrës për vitet 1416-1417. Aty përmenden Aleks Svinci (Alessio Suinci), që kishte prona në Shkodër dhe Andrea Svinci që po ashtu kishte prona aty, por që konsiderohet si kryengritës ndaj Venedikut, dhe si rrjedhim i humb pronat që kishte marrë me koncesion.<sup>121</sup> Më tej kemi Vukeq Svincin (*Uchexe Suinci*) me të birin Pal (Pallj) Svincin dhe Ivan (Juan) Svincin që jetonin në fshatin Dajç;<sup>122</sup> më tej, Nikolla dhe Vulkatë Svincin që jetonin në fshatin Patropat<sup>123</sup> dhe një Nikollë Svinci tjetër që jetonte në fshatin Prekal.<sup>124</sup>

Përsa i përket familjes *Sporo*, që ishte po ashtu nga Drishti, nuk dimë asgjë, vetëm se nga viti 1421 përmendet kleriku *Andreas Sporo*, që mesa duket ishte abat i një manastiri dedikuar Shën Gjonit.<sup>125</sup> Mbase këtu bëhet fjalë për manastirin e Shën Gjonit të Shtojtit, pjesë e Ipeshkëvisë së Drishtit që përmendëm edhe më sipër. Sot në krahinën e Shkodrës kemi shumë familje që mbajnë mbiemrin Shpori, por nëse ato kanë lidhje me

<sup>118</sup> *AAIb* II, nr. 391, ref. 1.

<sup>119</sup> *Po aty*, nr. 472.

<sup>120</sup> "Svino, Nobiles von Dulcigno im XV. Jahrhundert, de Suyno 1505, de Svinis 1521". Constantin Jireček, "I. Abhandlung: Die Romanen in den Städten Dalmatiens während des Mittelalters. II. Theil", në: *Denkschriften der Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften. Philosophisch-historische Klasse. Neunundvierzigster Band.* Wien: Carl Gerolds Sohn 1904. f. 64.

<sup>121</sup> *Registri 1416-1417*, fl. 3a; 9ab, 23 b, 24 ab, 30 b, 35 a, 129 a, 133 b, 137 b, 158 b.

<sup>122</sup> *Po aty*, fl. 97 b.

<sup>123</sup> *Po aty*, fl. 91 a.

<sup>124</sup> *Po aty*, fl. 110 b.

<sup>125</sup> "Sporo. In Drivasto frater Andreas S., abbas S. Joannis 1421." Jireček, "Romanen III ...", në: *Denkschriften ...*, f. 62.

të vërtetë me familjen mesjetare *Sporo* të Drishtit, këtë s' kemi mundur ta vërtetojmë ende.

Në vitin 1369 na paraqitet në Librin e Borxheve të Raguzës edhe një familje tjetër me mbiemrin *Tessil* apo *Cossil*. Nga kjo familje përmenden Aleks Kosili (Tesili) i Drishtit (*Alexius Cossil*) dhe i biri i tij prifti Mikael Kossili (*presbyter Michael filius condam Alexii Cossil de Drivasto*) i cili zotohet se do t'i paguante presbiterit Dhimiter të Drishtit (*Demetrio de Drivasto*) gjatë tre viteve në vazhdim 30 perperët që ia kishte marrë borxh.<sup>126</sup>

Nëpër dokumente të Raguzës paraqitet edhe një llogar familjar *Manganja (Ma(n)gagna)* dhe si përfaqësues të kësaj familjeje përmendet të vitin 1366 Andrea Pjetri Manganja (*Andreas Petri Ma(n)gagna de Drivasto*), i cili gjendet në atë kohë në Raguzë dhe punonte si shërbyes që prej 5 vjetësh tek Pietro de Srieua (*Petro de Çrieua*) me një rrogë prej 10 perperë në muaj.<sup>127</sup> Më tej nëpër dokumente ky mbiemër familjar nuk paraqitet asgjëkund.

\* \* \*

Pas pushtimit osman dhe braktisjes së Drishtit, një pjesë të mirë të këtyre familjeve e gjejmë jashtë trojeve shqiptare sidomos në Itali, veçanërisht në Republikën e Venedikut. Shumë pinjollë të këtyre familjeve, sidomos Engjëllorët, integrohen në jetën e atjeshme dhe bile bëhen edhe kontribuues në lëvizjen e Rilindjes (Rinascimento), por siç e thashë edhe më sipër, vazhdimi i historisë së këtyre familjeve, do ta kapërcente kuadrin e këtij artikulli, që ka si objekt studimi vetëm të dhënat mbi to në Drishtin mesjetar, para pushtimit osman. Të dhëna të mëtejshme mbi këto familje në Diasporë, do t'i paraqes në punimin tim *Drivasto, Historia dhe fizionomia e një qyteti mesjetar shqiptar* që është akoma në proces pune.

<sup>126</sup> "1369, 7 martii. Ragusii. Ego quidem presbyter Michael filius condam Alexii Cossil de Driavasto confiteor, quod (omissis) usque ad tre annos proxime futuros me obligo dare et soluere presbytero Demetrio de Drivasto pro omni debito, quod sibi dare debui de toto tempore preterito ad diem presentem, perperos XXX (aliis omissis) (Liber debitorum, 1362-1370, fol. 177)". AAlb II, nr. 254, ref. 2.

<sup>127</sup> "1366, 14. Aprilis, "Andrea Petri Ma(n)gagna de Drivasto" servilet Petro de Çrieua annos 5 pro perperis X". AAlb II, nr. 208, ref. 2.

*S u m m a r y*

## NOBLE FAMILIES IN THE MEDIEVAL DRINASO

This paper gives an overview of the most important families of the medieval town of Drisht, analyzing some of them. There were numerous noble families in Drisht of which we find evidence in different documents. However, similar to other aspects of Drisht's history, the research on the activity of these families in the political and economical life, inside the town or abroad can not be exhaustive as there are only a few and incomplete sources available. The story of these families after the Ottoman invasion of Drisht, some of which emigrate, will not be dealt with as this is not the focus of our research.

In this paper will be taken in consideration two groups of families. The first is composed of the main families which are found often in different documents and have played an important part in the history of Drisht, such as, Engjelli, Shpani, etc. while the second is composed of families of a lesser importance, the nobility of which has been put in doubt. Some of the latter are, Skepudar, Svinji, Zogi, etc.